

MANUAL PËRDORIMI

POS ANDROID AXIUM



NDEZJA/FIKJA E TERMINALIT POS ANDROID

Për ta ndezur, sigurohuni që bateria e terminalit POS të jetë e instaluar saktë dhe shtypni butonin e ndezjes (butoni i parë në të majtë të terminalit) për 2 deri në 3 sekonda, derisa ekrani të ndizet.

Për ta fikur terminalin, shtypni butonin e ndezjes për më shumë se 2 sekonda derisa në ekran të shfaqet menu-ja përkatëse për fikjen e terminalit.

SHITJE NORMALE

POS-i pranon karta Visa dhe Mastercard. Leximi I kartës në terminalin POS mundësohet në disa mënyra:

- Karta me Chip & PIN
- Pa kontakt (Contactless)
- Wallet

HAPI 1: Vendoset vlera/shifra që do të paguhet dhe kryhet konfirmimi me butonin "Jeshil".

Shtypni butonin e "Kuq" për të fshirë të gjitha shifrat ose shtypni butonin e "Verdhë" për të fshirë një vetëm një shifër.

HAPI 2: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në tre mënyra:

- Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)
- Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës
- Wallet

HAPI 3: Në ekran shfaqen mesazhet informuese "Në pritje, duke u dërguar/refuzuar" sipas rastit. Terminali do të shtypë faturë për tregtarin dhe do t'ju kerkoje të printoni një kopje të faturës për klientin e cila mund të konfirmohet me butonin "Jeshil" ose refuzohet me butonin e "Kuq".

Nëse fatura është e pa lexueshme në menu-në kryesore mund të zgjidhet "Reprint" dhe më pas të shtypet "last transaction".

ANULLIMI I VEPRIMIT

Në POS Credins mund të anulohet vetëm veprimi i fundit.

HAPI 1: Për të kryer anulimin e pagesës së fundit, zgjidhet në ekran menuja – ANULLIM

HAPI 2: Në ekran shfaqet kërkesa për të vendosur fjalekalimin I cili është: 0000

HAPI 3: Në ekran shfaqet kërkesa për të anuluar Transaksionin e Fundit.

HAPI 4: Në Ekran shfaqen detajet e transaksionit të fundit I cili duhet të konfirmohet me butonin "Jeshil". Pasi përfundon procedura printohet fatura. Kopja e klientit mund të zgjidhet të printohet sipas dëshires.

PARAAUTORIZIM

Në POS Credins mund të kryeni transaksione paraautorizim, ky transaksion shërben për bllokimin e fondeve në forme garancie për tregtarin.

HAPI 1: Zgjedhim Menu-në kryesore lart në të majtë.

HAPI 2: Zgjedhim Menu-në "Transaksionet"

HAPI 3: Zgjedhim opsionin "Paraautorizim"

HAPI 4: Vendoset shifra/vlera që do të bllokohet në formë garancie

Shtypni butonin e "Kuq" për të fshirë të gjitha shifrat ose shtypni butonin e "Verdhë" për të fshirë një vetëm një shifër.

HAPI 5: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në tre mënyra:

- Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)
- Contactless – Karta mbështetet pranë kapakut të letrës
- Wallet

PERFUNDIM PARAAUTORIZIM

HAPI 1: Zgjedhim Menu-në kryesore lart në të majtë.

HAPI 2: Zgjedhim Menu-në "Transaksionet"

HAPI 3: Zgjedhim opsionin "Përfundim"

HAPI 4: Vendoset shifra/vlera me të cilën do të përfundohet "Paraautorizim" dhe shtypni butonin Jeshil

"Përfundim Paraautorizimi" do të thotë se shifra/vlera e cila do të vendoset për "Përfundim" do të debitohet nga kartembajtësi. Shifra/vlera e "Përfundimit" nuk duhet të tejkalojë shifrën/vlerën e "Paraautorizim".

HAPI 5: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në tre mënyra:

- Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)
- Contactless – Karta mbështetet pranë kapakut të letrës
- Wallet

HAPI 6: Vendosni "Kodi I Autorizimit", I cili gjendet në faturën e transaksionit "Paraautorizim".

HAPI 7: Vendosni "RRN", I cili gjendet në faturën e transaksionit "Paraautorizim".

HAPI 8: Vendosni "Shuma Origjinale", e cila gjendet në faturën e transaksionit "Paraautorizim".

HAPI 9: Vendosni "Numri I Kontrollit", I cili gjendet në faturën e transaksionit "Paraautorizim".

SHITJE ME KËSTE

Në POS Credins mund të kryeni transaksione "Shitje me Këste", ky transaksion I mundëson kartembajtësit ndarjen e pagesës me këste ndërkohe që tregtarit i kreditohet vlera e plote në llogari. Ky transaksion suportohet vetëm për kartat Credins VISA Credit.

HAPI 1: Zgjedhim Menu-në kryesore lart në të majtë.

HAPI 2: Zgjedhim Menu-në "Transaksionet"

HAPI 3: Zgjedhim opsionin "Shitje me Këste"

HAPI 4: Vendoset vlera/shifra që do të paguhet dhe kryhet konfirmimi me butonin "Jeshil".

Shtypni butonin e **"Kuq"** për të fshirë të gjitha shifrat ose shtypni butonin e **"Verdhë"** për të fshirë një vetëm një shifër.

HAPI 5: Në ekran shfaqet "Kaloni kartën". Karta kalohet në tre mënyra:

- Me Chip (Vendoset karta me chip dhe kërkohet dhe PIN-i nga klienti)
- Contactless – Karta mbështetet sipër kapakut të letrës
- Wallet

HAPI 6: Pasi të kaloni kartën në ekran shfaqet mesazhi "Vendosni Numrin e Kësteve", ndarja e pagesës mund të kryhet nga 2 deri në 12 këste, kryhet konfirmimi me butonin "Jeshil"

- MOTO (Mail Order/Telephone Order)

HAPI 1: Zgjedhim Menu-në kryesore lart në të majtë.

HAPI 2: Zgjedhim Menu-në "Transaksionet"

HAPI 3: Zgjedhim opsionin "MOTO"

HAPI 4: Vendoset vlera/shifra që do të paguhet dhe kryhet konfirmimi me butonin "Jeshil".

Shtypni butonin e **"Kuq"** për të fshirë të gjitha shifrat ose shtypni butonin e **"Verdhë"** për të fshirë një vetëm një shifër.

HAPI 5: Vendoset numri i plote i kartës "PAN" dhe konfirmohet me butonin "Jeshil".

HAPI 6: Vendoset data e skadencës së kartës (MM/YY) dhe konfirmohet me butonin "Jeshil".

HAPI 7: Vendoset kodi verifikues i kartës (CVV) dhe konfirmohet me butonin "Jeshil".

RIPRINTIM FATURE

Në POS Credins mund të riprintohen faturat.

HAPI 1: Për të bërë riprintim fature në ekran zgjidhet menuja – "Riprinto"

HAPI 2: Në menu zgjedhim nëse do të riprintojmë transaksionin e fundit apo një të mëparshëm.

HAPI 3: Për të riprintuar transaksionin e fundit klikojmë "Printo transaksionin e fundit" dhe do të riprintohet automatikisht fatura.

HAPI 4: Për të riprintuar një transaksion që nuk është i fundit klikojmë "Sipas numrit të Faturës", përzgjedhim Numrin e faturës dhe klikojmë Konfirmo "Jeshil". Më pas do të riprintohet automatikisht fatura.

NDËRRIMI I LETRËS

Për të ndërruar rulonin e letrës, hapet kapaku sipër ekranit dhe vendoset një rulon letre i ri duke lënë pak letër jashtë të kapur nga kapaku i POS.

MBYLLJA DITORE

Mbyllja ditore duhet të realizohet në fundin e çdo dite nëse të paktën keni kryer një transaksion në POS Credins. Ky veprim zeron të gjitha veprimet e kryera atë ditë në POS.

Ky proces kryhet automatikisht dhe manualisht. Procesi automatik kryhet në një orar të përcaktuar pa nderhyrjen e tregtarit.

Ndërsa për të kryer mbylljen ditore manualisht ndiqen hapat e mëposhtme:

HAPI 1: Klikojmë Menu-në lart të majtë

HAPI 2: Klikojmë Shlyerja

HAPI 3: Vendosim fjalë kalimin

HAPI 4: Zgjedhim nëse do të printojmë Mbylljen ditore të detajuar apo të përmbledhur.

HAPI 5: Printohet Mbyllja ditore.

PËR SUPORT APO PYETJE KONTAKTONI

Orari: 08:30 – 17:00 nga e hëna në të premte
Cel: +355 67 60 56 278 / **Cel:** +355 67 60 60 960

Orari: 24/7
Kontakti i Call Centerit: +355 4 53 53 000